

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR,
PROJEKTI I NDËRTIMIT TË RRUGËS MILOT-RRËSHEN “MBI AUDITIMIN
E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin Rrugor Shqiptar, Projekti “Ndërtimi i rrugës Milot Rreshen” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 129, datë 15/09/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr.732/7, datë 15/09/2012 dërguar Z. Andi TOMA, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtëme:

A. Masa organizative

1. Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masa për planifikimin dhe përfshirjen në prioritetet e investimeve, të zgjerimit të segmentit rrugor Milot - Rreshen me dy korsi të tjera, sipas standardeve të parashikuara në ndërtimin e aksit rrugor Durrës-Kukës-Morinë, pjesë e së cilit është edhe segmenti rrugor i mësipërm.
2. Autoriteti Rrugor Shqiptar, të marrë masa për njoftimin e organeve përkatëse ligjore, për dëmtimet e shkaktuara në parmakët e Urës së Munazit, por edhe të elementeve të tjerë të aksit rrugor të rrugës Durrës-Kukës-Morinë, me qëllim vënien para përgjegjësisë të personave që kanë shkaktuar këto dëme si dhe parandalimin e aksidenteve e dëmtimeve të mëtejshme.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit me vlerë 35,220.4 USD, përfituar padrejtësisht nga Firma [REDAKTUAR], për punime të parealizuar sipas kontratës së zbatuar për Lot 2, segmenti rrugor Skuraj-Rubik.
2. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit me vlerë 41,623.8 USD, përfituar padrejtësisht nga Firma [REDAKTUAR], për punime të parealizuar sipas kontratës së zbatuar për Lot 3, segmenti rrugor Rubik-Rreshen.
3. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit me vlerë 46,314 USD, përfituar padrejtësisht nga Firma [REDAKTUAR], për punime të parealizuar sipas kontratës së zbatuar për Lot 1, segmenti rrugor Milot-Skuraj.

C. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në udhëzuesit e Bankës Botërore, Autoriteti Rrugor Shqiptar të shpallë si të papranueshëm në lidhjen e kontratave të mëtejshme për shërbime konsulente Kompaninë [REDAKTUAR], për mangësitë e rezultuara në zbatimin e kontratave të punimeve civile, shoqëruar me dëme ekonomike.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Artan Topjana, Luljeta Shtylla dhe Andi Buzo më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiri, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.